

## **AKT - THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE**

### **ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ERMI - PUMP**

“Ligji” eshte ligji Nr.9901 ,date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.

“Statuti “eshte statut i shoqerise.

#### **KAPITULLI I**

**Formimi,Emri,Objekti,Kohezgjatja dhe Selia Ligjore**

##### **NENI 1**

**Data e themelimit,Emri dhe Themeluesit**

1.Sot, me daten 25 Korrik 2017,ne themeluesit,kemi themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ERMI – PUMP sh.p.k e cila rregullohet me ligj dhe sipas ketij statuti.

2.Themeluesi I shoqerise eshte ;

Z.Roland Veseli I biri I Mehmetit , I datelindjes 03-03-1969 identifikuar me ID me Nr. personal G 90303198 V

##### **NENI 2**

#### **OBJEKTII VEPRIMTARISE**

Shoqeria do te kryeje veprimtarine si me poshte :

- Import – eksport dhe tregtimi i materialeve te ndryshme per ujesjellesa,gazsjellose dhe sisteme vaditje si dhe kryerja e punimeve ne kete fushe.Tregtim I materialeve elektrike, hidraulike dhe elektronike si dhe realizimi I punimeve ne kete fushe.
- Sherbim,riparim I makinave elektrike dhe I transformatoreve elektrik,elektropompa,elektromotor,transformator.
- Punime alumini,metali,ndertimi,dhe montimi.
- Import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te pijeve alkalike dhe jo alkalike ,dhe produkteve te tjera ushqimore

Faqe 1

##### **NENI 3**

**Kohezgjatja**

**Kohezigjatja e shoqerise do te jete per nje kohe te pacaktuar(pa afat)**

#### **NENI 4**

#### **SELIA**

**(1)Selia ligjore e shoqerise eshte ne adresen ; Fushe – Kruje, Fshati Hasan, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale nr. 1934, me numer pasurie 6/17**

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI**

#### **NENI 5**

#### **Kapitali themelues**

Kapitali fillestar I regjistruar i shoqerise eshte 100.000(njeqindemije) leke .

Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin themelor te shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre si vijon:

Ortaku themelues Roland Veseli :Zoterues I nje kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (Njeqindminje) leke qe perben 100 perqind te kapitalit te shoqerise .

Kontributi I ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (te luajtshme /te pasurive te paluajtshme apo te te drejtave ).Ortaket e kane shlyer kapitalin ne perputhje me perqindjet reiproke te kapitalit,ne para. Nese do te kete ortake tjere, te pranuar.sipas rregullave ne fuqi, shperndarja e fitimit do te behetsipas pjesmarrjes se kapitalit.

#### **NENI 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.**

Kapitali I shoqerise mund te Zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre ,nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto contribute sipas kerkeses se administratorit ne perputhje me ligjin ne fuqi

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Faqe 2**

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga aasambleja e ortakeve ,e cila merr vendim ne te njenjtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit .

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ortaket ne te njenjten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne

Ne çdo rast do të aplikohen parashikimet ligjore perkatese.

## **NENI 7**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit tën je shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributi në kapitalin e shoqërisë:
- b) shitblerjes:
- c) trashigimise
- ç) dhurimit
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj:

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **KAPITULLI III**

### **ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

## **NENI 8**

### **Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë .

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Për caktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) Ndryshimin e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve:
- d) Emerimin e shkarkimin e likuiduesëve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike

## **Faqe 3**

- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë:

- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë

- g) Shperndarjen e fitimit vjetor
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve:
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ,ne baze ten je autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme ,ecila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## **NENI 9**

### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

## **NENI 10**

### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose perçeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishme personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligjit. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## **Faqe 4**

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
  - b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
  - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - d) percaktimin e shperblimeve
  - e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se vemprimtarise;
  - f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj adminstratoreve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne te dhenat e shoqerise.

## NENI 12

### Perjashtimi nga e drejta e votes

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per ;

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij;
- d)dhenjen ose jot e perfitimeve te reja.

2.kur ortaku perfaqesohet nga nje pergfaqesues I autorizuar,I autorizuari vleresohet te jete ne te njenjtin konflikt interesi,ashtu si dhe ortaku,te cilin perfaqeson.

## NENI 13

### Administrimi

1.Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.Afati i emerimit,eshte 5 vjet,me te drejte riperteritje.

Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren. Kombetare te

Biznesit

**Faqe 5**

2.Administratoret e nje shoqerie tregtare meme,sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji,nuk mund te emerohen si administrator te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas.Çdo emerim i bere ne kundersizim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

**3. Personi i meposhtem caktohet si Administrator i shoqerise, per nje periudhe 5 –**

**vje care sipas ligjit.**

**Z. Roland Veseli I biri I Mehmetit ,I datelindjes 03.03.1969 e identifikuar me ID me Nr. personal G 90303198V**

**4. Administratori Roland Veseli emerohet per nje periudhe 5 vjecare konform ligjit.**

#### NENI 14

#### Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesim keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- dh) krijojne nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- e) kryejne regjistrime dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- f) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- g) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:  
-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

–shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

–shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne besnikerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne bazete marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Faqe 6**

NENI 15

**Pergjegjesite e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht , ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve , për shkëlqje të ligjeve , për shkëlqje të statutit , apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë , i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen , për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë , sipas nenëve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” , administrator detyrohet :

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi , duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi ceshtjet , për të cilat merret vendimi;
- ç) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit , prezent apo të mundshëm , të interesave personale me ato shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori , gjatë kryerjes së detyrave të tij , përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim , që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur , në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse , veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

2. Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale , sipas pikave 1 e 2 të këtij neni , është i detyruar t'i demshperblejë

### **Faqe 7**

shoqërisë demet , që rrjedhin nga kryerja e shkëlqjes , si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të

parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara . Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator , ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare .

3. Ne menyre te vecante , por pa u kufizuar ne to , administartori eshte I detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara , nese ne kundershtrim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" , kryen veprimet e meposhtme :
- a) U kthen ortakeve kontributet;
  - b) U paguan ortakeve interesa apo dividende;
  - c) U shperndan aktivet shoqerise;
  - ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare , kur ne baze te gjendjes financiare , duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet ;
  - d) jep kredi

Pevec padise per shlyerjen e demit qe I ngarkohet personalisht administratorit , ortaket individualisht ose se bashku , kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise , perfshire edhe demshperblimin financiar , nese eshte e nevojshme . Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## **Kapitulli IV**

### **Viti financiar -ekspertet**

**NENI 16**

**Faqe 8**

### **Viti Financiar**

Viti financiar iShoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.



Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### NENI 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise , ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushturara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara , te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimtare qe ka.

#### Kreu V

Prishja –riorganizimi I shoqerise

#### NENI 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 , date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

#### **Faqe 9**

d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrnin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e

likuidimit te shoqerise , duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likudim e siper”.

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese , me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrnin nje vendim per emerimin e likuiduesve , brenda 30 diteve pas prishjes , çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykates , per te caktuar nje likuidues.

#### NENI 19

##### Riorganizimi i shoqerise bashkimi –ndarja

Shoqeria mund te ndahet , bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare.”

#### NENI 20

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut , do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### NENI 21

##### Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij

#### **Faqe 10**

statuti , se dhe per çdo mosmarveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve , do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt themelimi dhe statut eshte hartuar ne dy kopje orgjinale, me vlere te njejte ligjore sipas vullnetit dhedeshires se plote te ortakut themelues, i cilimarrin persiper plotesimin dhe respektimin e tij.

Ky statut do te shperndahet ne kete menyre:

- Nje kopje Q.K.B.
- Nje kopje si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

NENI 22

Hyn ne fuqi dite e nenshkrimit te tij.

**ORTAKU I VETEM**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**Roland VESELI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Roland Veseli', written over a horizontal line.